

Rekomandime Politikash për Veprim Klimatik në Shqipëri



Për zhvillimin e një Strategjie Kombëtare
për ACE me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse
dhe përpjekje të koordinuara

Rekomandime Politikash për Veprim Klimatik në Shqipëri

Për zhvillimin e një Strategjie Kombëtare për ACE me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe përpjekje të koordinuara.

Nga integrimi i edukimit për klimën në shkolla e deri te pjesëmarrja e publikut dhe shkëmbimi transparent i informacionit, Shqipëria përballlet me detyrën urgjente të kthejë ndërgjegjësimin për klimën në veprim. Ndërsa institucionet, shoqëria civile dhe aktorët lokalë punojnë për t'u përafuar me angazhimet ndërkombëtare për klimën, interesa, mungesa kapacitetesh dhe boshllëqe të shumta shfaqen në proces. Si mund të ndërtojë Shqipëria një qasje koherente dhe gjithëpërfshirëse ndaj Fuqizimit për Veprim Klimatik (ACE), në përputhje me programin e punës të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)? Cilat janë pengesat në zbatim dhe cilat janë hapat që duhen ndërmarrë për ti kapërcyer ato?

Ky dokument politikash përmbledh gjetjet kryesore dhe rekomandime të zbatueshme se si Shqipëria mund të hartojë dhe institucionalizojë një strategji mbi ACE, të përshtatur për kontekstin e saj kombëtar. Një strategji që fuqizon qytetarët, forcon institucionet dhe mbështet qëndrueshmërinë afatgjatë ndaj klimës.

Gjetjet kryesore

1. Strategji Kombëtare për ACE

Shqipëria duhet të zhvillojë dhe miratojë një Strategji Kombëtare gjithëpërfshirëse për ACE, në përputhje me Marrëveshjen e Parisit dhe Programin e Punës së UNFCCC në Glasgow. Kjo strategji duhet të përfshijë një vizion afatgjatë dhe objektiva të qarta për secilin element të ACE: edukimi, trajnimi, ndërgjegjësimi publik, pjesëmarrja e publikut, qasja në informacion dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, mbështetur nga një mekanizëm i dedikuar koordinimi brenda Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Strategjia duhet të jetë e bazuar në të dhëna të sakta dhe e mbështetur nga një strukturë e qëndrueshme financimi dhe monitorimi.



2. Platformë Digjitale për Veprim Klimatik

Rekomandohet krijimi i një platforme kombëtare informimi dhe angazhimi të shoqërisë civile mbi ACE për të rritur transparencën, dukshmërinë dhe angazhimin e shoqërisë civile. Projektuar si një platformë publike digjitale e udhëhequr nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, do t'u mundësonte organizatave mjedisore, grupeve të rinjve, edukatorëve dhe komuniteteve të ngarkojnë, ndajnë dhe raportojnë mbi aktivitetet e lidhura me klimën. Kjo platformë do të shërbente si një arkivë kombëtare e praktikave të mira dhe një mjet raportimi që të mund të përdoret për monitorimin e zbatimit të ACE në Shqipëri.



3. Integrimi i Edukimit për Klimën në Arsim

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në partneritet me aktorët përkatës, duhet të udhëheqë integrimin e plotë të edukimit për klimën në sistemet e arsimit formal dhe joformal. Kjo përfshin rishikimin e kurrikulave, zhvillimin e materialeve mësimore kombëtare dhe institucionalizimin e trajnimit të mësuesve për tema të qëndrueshmërisë. Në të njëjtën kohë, mësimi joformal, përmes nismave të udhëhequra nga të rinjtë, programeve komunitare dhe mjeteve dixhitale, duhet të rritet, veçanërisht në zonat rurale dhe më të prekura nga ndryshimet klimatike.



Historiku dhe konteksti

Shqipëria, një vend në Ballkanin Perëndimor i ngjashëm me vendet e saj fqinje, është gjithnjë e më i prekshëm ndaj ndikimeve të shumta të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë rritjen e temperaturave, ngjarjet ekstreme të motit dhe degradimin e mjedisit.

Shqipëria, si të gjitha vendet që kanë ratifikuar Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) dhe Marrëveshjen e Parisit, ka një detyrim të qartë: të sigurojë që qytetarët e saj të jenë të edukuar, të informuar, të aftë dhe të fuqizuar për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe zbatimin e masave për veprim klimatik. Ky detyrim sipas UNFCCC¹ quhet Fuqizim për Veprim Klimatik (ACE).

¹ Zyrtarizuar në nenin 6 të UNFCCC dhe nenin 12 të Marrëveshjes së Parisit

Gjetjet e marra nga një pyetësor mbarëkombëtar dhe një fokus grupi i organizuar me aktorë të shoqërisë civile nënvizojnë rëndësinë e ACE në Shqipëri. Të anketuarit përgjithësisht pajtohen se ACE është thelbësore në kontekstin shqiptar, veçanërisht për shkak të rritjes së ndikimeve klimatike dhe mungesës së ndërgjegjësimit të publikut të gjërë. Shumica e të anketuarve theksuan se ndërgjegjësimi për ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tij mbetet i kufizuar vetëm tek profesionistët ose aktivistët, ndërsa popullsia më gjërë mbetet ende e painformuar ose apatike.

ACE përfshin gjashtë elementë: edukimin për ndryshimet klimatike, trajnimin, ndërgjegjësimin e publikut, pjesëmarrjen e publikut, aksesin në informacion dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Këta komponentë janë thelbësorë për pajisjen e individëve dhe komuniteteve me njohuritë, aftësitë për t'u angazhuar në mënyrë aktive në veprimin për klimën dhe proceset politike.

Gjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka integruar disa elementë të ACE në strategjitë kombëtare dhe instrumentet ligjore, duke përfshirë Ligjin për Ndryshimet Klimatike (Nr. 155/2020), Kontributin e Përcaktuar në Nivel Kombëtar (NDC 2021) dhe Planin Kombëtar të Përshtatjes (NAP). Këto dokumente janë pjesë e angazhimit formal të qeverisë për angazhimin publik, politikëbërjen gjithëpërfshirëse dhe reformën arsimore në përputhje me objektivat globale të klimës. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (NECP) thekson më tej rëndësinë e ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe sigurimit të angazhimit aktiv të publikut.

Megjithatë, zbatimi në terren mbetet i fragmentuar dhe shpesh i përkohshëm, veçanërisht për sa i përket koordinimit ndërsektorial dhe institucionalizimit afatgjatë. Megjithëse ekzistojnë ligje dhe strategji të ndryshme kombëtare, ka boshllëqe të konsiderueshme në praktikë, veçanërisht në nivel lokal dhe midis grupeve vulnerabël dhe ato të prekura më së shumti nga ndryshimet klimatike.

Edukimi për ndryshimet klimatike përfshihet pjesërisht në kurrikulat formale përmes lëndëve të tilla si biologjia, gjeografia dhe edukimi qytetar. Disa universitete, veçanërisht Universiteti Bujqësor i Tiranës, ofrojnë lëndë të specializuara në politikën dhe përshtatjen mjedisore. Megjithatë, ka një mungesë të dukshme të programeve të dedikuara dhe Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm (ESD) ende nuk është integruar nga klasat e hershme (filllore) deri në shkollën e mesme. Qasjet pedagogjike mbeten kryesisht tradicionale, me përmbajtje të kufizuara ndërdisiplinore dhe trajnime të pamjaftueshme për edukatorët mbi temat e qëndrueshmërisë.

Iniciativat e trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve, megjithëse të pranishme në korniza të ndryshme politikash, prirjen të jenë të drejtuara nga donatorët, të jenë jokonsistente dhe pa vazhdimësi institucionale. Ndërsa Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka iniciuar përpjekje të caktuara, duke përfshirë vlerësime dhe iniciativa të lokalizuara për ngritjen e kapaciteteve, nuk ka kurrikula kombëtare ose certifikim të posaçëm për trajnimin për klimën. Bashkitë, të cilat shpesh operojnë me burime të kufizuara teknike dhe financiare, përballen me vështirësi në rritjen e kapaciteteve të brendshme për të adresuar planifikimin dhe veprimin e lidhur me klimën.

Përpjekjet për ndërgjegjësimin e publikut shpesh përfshijnë fushata afatshkurtra, siç është nisma 'Java e Klimës' në Shqipëri, e cila përkon me Konferencën e Palëve (COP). Kjo nismë mbështetet kryesisht nga donatorë ndërkombëtarë dhe zbatohet në partneritet me institucionet publike.

Pjesëmarrja publike është një e drejtë e garantuar ligjërisht sipas Konventës së Aarhus, të cilën vendi e ka ratifikuar, si dhe legjislacionit shqiptar, veçanërisht Ligjit Nr. 10431/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" dhe Ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Ministrinë duhet të kryejnë konsultime me palët e interesuara gjatë hartimit të politikave për klimën. Megjithatë, ndonjëherë pjesëmarrja mbetet procedurale dhe pa ndikim. Të anketuarit dhe pjesëmarrësit në fokus grup theksuan përfshirjen e kufizuar të shoqërisë civile dhe grupeve të marginalizuara, si dhe mungesën e mekanizmeve që sigurojnë ndjekje ose llogaridhënie në proceset e konsultimit.

Përrsa i përket qasjes në informacion përpos Ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", Agjencia Kombëtare e Mjedisit menaxhon një platformë për shpërndarjen e të dhënave mjedisore. Megjithatë, në praktikë, këto burime janë shpesh të vështira për t'u aksesuar dhe për t'u kuptuar nga popullata e gjërë, si dhe nuk janë të dizajnuara duke pasur parasysh përdoruesin. Informacioni nuk është i përshtatur për komunitetet lokale, fermerët dhe bizneset e vogla, si dhe ka një mungesë të infrastrukturës digjitale në zonat rurale e cila është e nevojshme për të pasur një qasje më të gjerë publike në të dhëna.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është relativisht i fortë, pasi Shqipëria merr pjesë në disa programe rajonale dhe të financuara nga BE-ja të cilat fokusohen në edukim dhe përshtatjen ndaj klimës. Projekte të ndryshme kanë kontribuar në zhvillimin e kurrikulës dhe partneritetet institucionale. Megjithatë, rezultatet nga iniciativat ndërkombëtare rrallë institucionalizohen, gjë që kufizon ndikimin e tyre transformues.

Nga të dhënat e mbledhura nga pyetësi dhe fokus grupi, elementet si edukimi, trajnimi dhe ndërgjegjësimi u përmendën si më të zbatuarat nga shoqëria civile, shpesh përmes seminareve, fushatave dhe angazhimit lokal. Ndërsa, pjesëmarrja e publikut dhe qasja në informacion u identifikuan si elementët më pak të zhvilluar. Organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e komunitetit shpesh theksonin pengesat burokratike, mbështetjen e paqëndrueshme institucionale dhe mungesën e përafrimit strategjik midis qeverisë dhe iniciativave bazë.

Për më tepër, koordinimi midis aktorëve të ndryshëm, institucioneve, shoqërisë civile, komuniteteve rezulton i fragmentuar. Iniciativat e lidhura me ACE janë shpesh afatshkurtra, të bazuara në projekte dhe të varura nga financimi i jashtëm. Mungesa e një mekanizmi qendror monitorimi për ACE e thëllon më tej këtë sfidë.

Ky Dokument Politikash nga RIFS është përgatitur nga Deborah Lika, studiuese e asociuar në institut, si pjesë e projektit "Situation Analysis of ACE Implementation in Albania: Building a Policy Roadmap"

Ky Dokument Politikash i RIFS duhet të referohet si:

D. Lika. (2025). Rekomandime Politikash për Veprim Klimatik në Shqipëri, RIFS Policy Paper, (2).



Fushat kryesore problematike dhe nevojat urgjente për avancimin e ACE në Shqipëri

Të identifikuara përmes një pyetësori mbarëkombëtar dhe një fokus grupi, këto fusha prioritare pasqyrojnë pengesat dhe mundësitë më urgjente për zbatimin e ACE në Shqipëri.


1. Fragmentarizimi i përpjekjeve dhe mungesa e koordinimit strategjik
2. Kapacitet i pamjaftueshëm institucional dhe mungesë e angazhimit politik
3. Mungesë e integritit të plotë të edukimit mbi ndryshimet klimatike
4. Ndërgjegjësimi i ulët i publikut dhe aksesit në informacion
5. Angazhimi i kufizuar i qytetarëve në çështjet e klimës.
6. Mungesa e sistemeve të qëndrueshme të financimit dhe monitorimit

Nevojat urgjente

- Një strategji kombëtare mbi ACE ose një plan veprimi
- Strukturat e dedikuara institucionale dhe bashkëpunimi ndërministror
- Integrimi sistematik i edukimit për klimën
- Mekanizmat e qëndrueshëm të financimit
- Iniciativa të synuara të ndërgjegjësimit publik
- Mekanizma të forcuara për pjesëmarrje publike


Një kornizë kombëtare monitorimi dhe vlerësimi të implementimit të ACE Duke u bazuar tek sfidat dhe boshllëqet e identifikuara, ky dokument politikash propozon tre rekomandime strategjike dhe të zbatueshme si një fazë fillestare për të forcuar zbatimin e ACE në Shqipëri. Këto rekomandime janë në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare por të bazuara në kontekstin kombëtar dhe të hartuara për të promovuar një qasje të gjithë shoqërisë ndaj fuqizimit për veprim klimatik.

1. Zhvillimi dhe miratimi i një strategjie kombëtare për ACE me një mekanizëm të dedikuar koordinimi



Një hap themelor për të filluar zbatimin e Kornizës së ACE në Shqipëri është zhvillimi i një Strategjie Kombëtare për ACE ose Plani Veprimi për ACE.

Kjo strategji duhet të përputhet me nenin 12 të Marrëveshjes së Parisit si dhe me Programin e Punës së Glasgow për ACE, duke u përshtatur gjithashtu me kontekstin specifik institucional, arsimor dhe socio-kulturor të Shqipërisë. Strategjia duhet të artikulojë një vizion afatgjatë dhe ta përkthejë atë në një kornizë koherente me qëllime të qarta, parime ndërsektoriale (p.sh., përfshirja, barazia, transparencja) dhe rezultate të matshme për të gjashtë elementët e ACE: arsimi, trajnimi, ndërgjegjësimi i publikut, pjesëmarrja e publikut, aksesimi në informacion dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.



Komponentët kryesorë dhe veprimet për një strategji kombëtare ACE:

Një vlerësim kombëtar bazë i secilës prej elementëve të ACE është i nevojshëm për të identifikuar boshllëqet, nevojat e palëve të interesuara, praktikat e mira ekzistuese dhe njohuritë e përgjithshme që qytetarët shqiptarë kanë për ndryshimet klimatike dhe çështjet mjedisore. Praktikrat e suksesshme në vende të tjera tregojnë se, në mënyrë që ky vlerësim të jetë efektiv, është e rëndësishme të ketë pjesëmarrje të gjërë, të përfshihet shoqëria civile, të rinjtë, edukatorët, qeveritë lokale dhe komunitetet vulnerabël. Ky vlerësim bazë është i rëndësishëm për të patur një pamje të qartë se ku qëndron Shqipëria aktualisht në zbatimin e gjashtë elementëve të ACE dhe njëkohësisht duke identifikuar pikat e forta ekzistuese, boshllëqet institucionale, nevojat e palëve të interesuara dhe praktikrat premtuese. Në mënyrë që ky proces të jetë efektiv dhe të rrisë besimin e palëve të interesuara, ai duhet të hartohet duke angazhuar dhe shoqërinë civile.

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare të ACE, çdo element duhet të zbatohet përmes objektivave specifike, të mbështetur nga veprime konkrete, grupe të synuara të përcaktuara, afate kohore të qarta dhe tregues të matshëm të performancës në përputhje me kontekstin ligjor, institucional dhe socio-kulturor të Shqipërisë. Për shembull:

Elementi ACE	Objektivi strategjik	Grupet e synuara	Afati kohor	Treguesit e performancës
Arsimi	Integrimi i çështjeve të ndryshimeve klimatike dhe Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm (ESD) në kurrikulat parauniversitare dhe praktikrat e mësimdhënies	Nxënësit (klasat 1–12), Mësuesit, Hartues të politikave arsimore	Afatmesëm (3–5 vjet)	% e shkollave që kanë futur përmbajtjen e përditësuar mbi klimën; # të edukatorëve të trajnuar
Trajnim	Rritja e kapaciteteve të zyrtarëve publikë, edukatorëve dhe profesionistëve në fushat që lidhen me klimën	Nëpunësit civilë, Mësuesit, Gazetarët, Pushteti lokal	Afatmesëm dhe afatgjatë (3–8 vjet)	Numri i personave të certifikuar; Numri i institucioneve që ofrojnë trajnime për klimën
Ndërgjegjësimi i publikut	Rritja e ndërgjegjësimit publik për ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe mënyrat e reagimit	Publiku i gjerë, Komunitetet rurale, Të rinjtë, Mediat	Afatmesëm (2–5 vjet)	Shtrirja e fushatave; % e rritjes së ndërgjegjësimit për klimën (bazuar në sondazhe)
Pjesëmarrja e publikut	Mundësimi i pjesëmarrjes në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar të publikut në procesin e hartimit të politikave klimatike	Organizatrat e shoqërisë civile, Të rinjtë, Gratë, Komunitetet lokale	Afatmesëm (3–5 vjet)	numri i konsultimeve të mbajtura; Diversiteti i pjesëmarrësve; Kontributet e dokumentuara të politikave
Qasje në informacion	Përmirësimi i aksesit në të dhënat dhe burimet klimatike në kohë, të sakta dhe të lehta për tu përdorur	Fermerët, Studentët, Edukatorët, Autoritetet lokale	Afatmesëm (2–4 vjet)	Numri i përdoruesve që aksesojnë platformat digjitale; Vlerësimet e kënaqësisë; Frekuenca e përditësimit të të dhënave
Bashkëpunimi Ndërkombëtar	Forcimi i angazhimit nëpërmjet iniciativave dhe partnerëve rajonal dhe global të ACE	Institucionet qeveritare, Akademia, OJF-të	Afatgjatë (5–10 vjet)	Numri i projekteve ndërkombëtare; Pjesëmarrja në rrjetet ACE; Burimet e mobilizuar

Për të siguruar zbatimin e Strategjisë mbi ACE, Shqipëria duhet të forcojë rolin e Pikës së Kontaktit të ACE (ACE focal Point) duke integruar përgjegjësitë mbi ACE në Drejtorinë e Ndryshimeve Klimatike brenda Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për të mbështetur aspektet operacionale të zbatimit të ACE. Këto përfshijnë raportimin, koordinimin e aktiviteteve, monitorimin dhe ndjekjen e nismave kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të UNFCCC. Ndërsa Shqipëria aktualisht ka një pikë kontakti të caktuar zyrtarisht për ACE nën UNFCCC, ky rol nuk është përmbushur në mënyrë aktive. Institucionalizimi i mbështetjes përmes një mekanizmi të fokusuar dhe me burime të mira brenda Zyrës për Ndryshimet Klimatike, do të rriste vazhdimësinë, logaridhënien dhe kapacitetin për të zbatuar strategjinë.

ACE, nuk duhet të trajtohet si një çështje e izoluar mjedisore, por duhet të jetë e integruar në të gjithë sektorët përkatës. Kjo është arsyeja pse, një grup koordinues ose task forcë zyrtare sugjerohet të krijohet për të siguruar integrimin e elementeve të ACE në disa sektorë të ndryshëm. Ky grup duhet të përfshijë përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe institucione të tjera relevante. Roli i këtij grupi do të ishte të përafrojë politikën, të planifikojë së bashku dhe të buxhetojë veprimet e ACE si dhe të rishikojë rregullisht progresin. Grupi mund të përfshijë grupe pune të fokusuar në arsimin, angazhimin e të rinjve, qasjen digjitale në informacion dhe ngritjen e kapaciteteve. Gjithashtu duhet të përfshijë ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Strategjia e ACE duhet të integrohet me instrumente më të gjera të politikave për klimën në Shqipëri, të tilla si Kontributi i Përcaktuar Kombëtar (NDC), Plani Kombëtar i Përshtatjes (NAP) dhe Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (NECP), për të siguruar përafrimin e politikave dhe për të shfrytëzuar sinergjitë ndërsektoriale.

Hartimi i një plani financimi dhe mobilizimi të burimeve

Që Strategjia ACE të jetë e qëndrueshme, ajo duhet të mbështetet nga një plan i dedikuar dhe realist i financimit dhe mobilizimit të burimeve. Ky plan duhet të jetë pjesë integrale e strategjisë dhe duhet të përshkruajë se si burimet do të sigurohen, ndahen dhe monitorohen në gjashtë elementët e ACE.

Strategjia duhet të identifikojë linja specifike buxhetore për aktivitetet e ACE brenda ministrive përkatëse, veçanërisht Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Kjo përfshin buxhetimin për reformën arsimore, fushatat e ndërgjegjësimit publik, programet e trajnimit dhe infrastrukturën digjitale për të mbështetur aksesin në informacion. Integrimi i kostove të lidhura me ACE në buxhetet sektoriale do të sigurojë angazhim institucional afatgjatë dhe do të zvogëlojë varësinë nga ndërhyrjet afatshkurtra të bazuara në projekte.

Përveç financimit publik, strategjia duhet të krijojë një mekanizëm për angazhimin e donatoreve, organizatave dhe mekanizmave ndërkombëtarë të financimit të klimës. Për shembull, Shqipëria mund të përafrojë prioritetet e ACE me mbështetjen ekzistuese në kuadër të Axfordës së Gjellbër të BE-së për Ballkanin Perëndimor, programet e UNDP ose Fondit të Gjellbër për Klimën (GCF). Njësia koordinuese e ACE duhet të ketë për detyrë të identifikojë mundësitë e financimit, dhe të mbështesë zhvillimin e strategjisë.

Strategjia gjithashtu duhet të eksplorojë mënyra për të angazhuar sektorin privat, si burim financimi dhe partner zbatues. Bizneset, veçanërisht në turizëm, bujqësi dhe teknologji, mund të mbështesin ACE përmes partneriteteve publike-private (PPP), programeve të përgjegjësisë sociale të korporatave (CSR) ose përpjekjeve të bashkëfinancuara për arsim dhe trajnim. Mobilizimi i burimeve duhet të përfshijë jo vetëm kapitalin financiar, por edhe kontributet në natyrë, shkëmbimin e njohurive dhe burimet njerëzore. Partneritetet me universitete, media, OJF dhe organizata komunitare mund të zgjerojnë shtrirjen dhe ndikimin e iniciativave ACE, veçanërisht në nivel lokal.

Së fundi, plani i financimit duhet të përfshijë mekanizma për transparencë dhe llogaridhënie, të tilla si raportimi financiar vjetor, transparenca e burimeve të financimit dhe rishikime periodike.

1. Shqipëria ka nevojë për një strategji të dedikuar për ACE me një mekanizëm koordinues dhe vizion afatgjatë.

2. Strategjia Kombëtare mbi ACE duhet të ndërtohet në përputhje me gjashtë elementët e ACE dhe të ketë mbështetje të fortë institucionale.

3. Një platformë digjitale për ACE do të rriste me tej transparencën dhe angazhimin e shoqërisë civile.

4. Shoqëria civile duhet të jetë bashkë-dizenjuuese dhe të përdorë në mënyrë aktive platformën e ACE që ajo të ketë ndikim dhe të jetë efektive.

2. Krijimi i një Platforme Kombëtare e Informimit dhe Angazhimit për Shoqërinë Civile mbi ACE



Një rekomandim kyç për të rritur koordinimin, transparencën dhe përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në zbatimin e ACE në Shqipëri është zhvillimi i një platforme digjitale interaktive dhe të aksesueshme kushtuar ACE dhe gjashtë elementëve të saj.

Kjo platformë duhet të hartohet dhe menaxhohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe përfaqësues nga shoqëria civile dhe academia. Qëllimi kryesor i kësaj platforme do të ishte sigurimi i një hapësire ku organizatat mjedisore, të rinjtë, edukatorët, dhe komunitetet që punojnë me klimën të mund të ngarkojnë, shfaqin dhe raportojnë mbi aktivitetet e tyre të edukimit, ndërgjegjësimit dhe angazhimit.

Aktualisht, përpjekjet e shoqërisë civile në Shqipëri janë shpesh të fragmentuara, të padokumentuara dhe të shkëputura nga raportimi kombëtar i klimës. Kjo platformë do të shërbente si një urë shumë e nevojshme midis veprimit nga poshtë-lart dhe planifikimit nga lart-poshtë, duke lejuar që shoqëria civile të shihet, të mbështetet dhe të përfshihet sistematikisht në agjendën e ACE në vend dhe jo vetëm.

Platforma duhet të jetë e dizajnuar për të qenë intuitive, e aksesueshme dhe të ketë përdorje të gjërë nga aktorë lokalë me nivele të ndryshme në shkrim dhe lexim digjital. Karakteristikat kryesore mund të përfshijnë:

- Një portal i dedikuar ku aktorët e regjistruar të shoqërisë civile mund të regjistrojnë aktivitetet e tyre, të ngarkojnë raporte, të ndajnë rezultatet e aktiviteteve, ose të shënojnë fushatat aktive nën gjashtë elementët e ACE;
- Një kalendar i aktiviteteve të ardhshme (p.sh. punëtori, konsultime, fushata sensibilizuese, seanca trajnimi), i hapur si për kontribuesit ashtu edhe për publikun;
- Një bibliotekë digjitale burimesh ku përdoruesit mund të shkarkojnë udhëzues praktikë, module trajnimi, infografikë, të dhëna klimatike dhe legjislacion përkatës;
- Një hartë e aktorëve të klimës sipas rajonit, temës ose fushës së fokusit të ACE, me qëllim gjetjen e informacionit përkatës në zona të caktuara dhe shmangien e përsëritjes së veprimtarive;
- Modele raportimi opsionale që mund të përdoren si kontribute vullnetare në kuadër të monitorimit kombëtar të ACE, rishikimeve vjetore dhe raporteve ndërkombëtare.

Për të siguruar kontrollin e cilësisë dhe llogaridhënien, platforma duhet të menaxhohet nga një ekip teknik brenda Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit,

“Aktualisht, përpjekjet e shoqërisë civile në Shqipëri janë shpesh të fragmentuara, të padokumentuara dhe të shkëputura nga raportimi kombëtar i klimës.”

me mbështetjen e një grupi këshillimor me pjesëmarrje të gjerë aktorësh, përfshirë organizata pjestimore, të rinjtë, përfaqësues të universiteteve dhe aktorë bashkiakë. Ky grup duhet të marrë pjesë në bashkë-dizajnimin e strukturës së përmbajtjes së platformës, duke ruajtur transparencën dhe duke ofruar komente të rregullta për të garantuar që sistemi të mbetet gjithëpërfshirës. Rekomandohet që udhëzimet mbi mënyrën e regjistrimit të aktiviteteve dhe ndërveprimin me mjetin të zhvillohen në konsultim me shoqërinë civile, për të garantuar lehtësinë e përdorimit. Qeveria duhet gjithashtu të investojë në ndërmarrjen e masave për ngritjen e kapaciteteve për përdorimin e platformës. Kjo përfshin sesione trajnimi online dhe me prani fizike, angazhim të synuar në zonat rurale dhe përgatitjen e udhëzuesve për përdoruesit, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë. Platforma duhet gjithashtu të promovohet përmes mediave kombëtare, javëve të klimës, rrjeteve të donatorëve dhe sistemeve arsimore, për të rritur ndërgjegjësimin mbi qëllimin dhe përfitimet e saj.

Megjithatë, kjo platformë nuk duhet të kufizohet vetëm në ndarjen e informacionit, por duhet të shërbejë si një mjet raportimi dhe angazhimi. Të dhënat e mbledhura përmes këtij sistemi mund të përdoren drejtpërdrejt në monitorimin dhe vlerësimin që duhet të detajohet brenda Strategjisë ACE. Qëllimi i një pamjeje më të plotë të zbatimit të ACE në vend. Kjo gjithashtu përputhet me qëllimet ndërkombëtare të transparencës klimatike sipas UNFCCC dhe do ta forconte më tej raportimin e Shqipërisë në Konventë .


Në mënyrë që ajo të jetë e qëndrueshme dhe e vazhdueshme, platforma duhet të institucionalizohet brenda njësisë koordinuese të ACE të propozuar në kuadër të Strategjisë ACE, dhe zhvillimi dhe mirëmbajtja e saj duhet të mbështetet përmes alokimeve të dedikuara të buxhetit kombëtar dhe kur është e mundur, financimit të donatorëve. Ky do të ishte një hap i rëndësishëm drejt demokratizimit të veprimit për klimën, njohjen e aktorëve bazë dhe rritjen e pjesëmarrjes dhe transparencës në lidhje me ACE.

Nga integrimi i edukimit për klimën në shkolla e deri te pjesëmarrja e publikut dhe shkëmbimi transparent i informacionit, Shqipëria përballlet me detyrën urgjente të kthejë ndërgjegjësimin për klimën në veprim. Ndërsa institucionet, shoqëria civile dhe aktorët lokalë punojnë për t'u përafuar me angazhimet ndërkombëtare për klimën, interesa, mungesa kapaciteteve dhe boshllëqe të shumta shfaqen në proces. Si mund të ndërtojë Shqipëria një qasje koherente dhe gjithëpërfshirëse ndaj Fuqizimit për Veprim Klimatik (ACE), në përputhje me programin e punës të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)? Cilat janë pengesat në zbatim dhe cilat janë hapat që duhen ndërmarrë për ti kapërcyer ato?

Shigjeta njëkahëshe — Fluksi i përgjegjësisë ose aksesit pa reagime të drejtpërdrejta. Për shembull: publiku i gjerë akseson informacionin, por nuk e menaxhon ose përditëson sistemin.

Shigjetat e dyanshme — Ndërveprim i vazhdueshëm, bashkëpunim ose llogaridhënie. Për shembull: Shoqëria civile kontribuon dhe përfiton nga platforma duke i bërë ata përdorues dhe kontribues.

Shigjetat poshtë — Delegimi ose mbikëqyrja, nga një institucion i nivelit më të lartë (si Ministria) në organet teknike ose zbatuese.



3. Integrimi sistematik i edukimit për klimën në sistemet e arsimit formal dhe joformal



Integrimi i edukimit për ndryshimet klimatike në sistemet arsimore formale dhe joformale në Shqipëri është thelbësor për nxitjen e një shoqërie të ndërgjegjshme ndaj klimës dhe proaktive.

Kjo kërkon një reformë gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë të kurrikulave kombëtare në të gjitha nivelet, nga arsimi fillor deri te ai i lartë, duke e përfshirë ndryshimin klimatik, qëndrueshmërinë mjedisore dhe qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve si dhe tema ndërdisiplinore në lëndë të tilla si shkenca, gjeografia, edukata qytetare, arti dhe teknologjia.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, duhet të udhëheqë zhvillimin e moduleve arsimore të standardizuara dhe të përshtatshme për moshën. Përveç rritjes së ndërgjegjësimit mbi rreziqet dhe cenueshmëritë mjedisore, edukimi për klimën duhet të promovojë narrativa pozitive dhe vizione fuqizuese për të ardhmen. Nxënësit duhet të inkurajohen ta shohin veprimin klimatik jo vetëm si një domosdoshmëri, por edhe si një mundësi për të krijuar komunitete më të shëndetshme, mjedise më të pastra dhe ekonomi më gjithëpërfshirëse.

Mësimet duhet të përfshijnë histori suksesi lokale dhe globale, të evidentojnë rrugë drejt karrierave të gjelbra dhe të prezantojnë qasje praktike, të orientuara drejt zgjidhjes, që lidhen me energjinë e pastër, bujqësinë e qëndrueshme dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë, të cilat kontribuojnë në një cilësi më të mirë jete. Këto module duhet të pasqyrojnë realitetet mjedisore dhe cenueshmëritë socio-ekonomike specifike të Shqipërisë, si humbja e biodiversitetit dhe emetimet e lidhura me turizmin, dhe të mbështeten nga materiale pedagogjike të aksesueshme, të përshtatshme për mësuesit, si dhe burime të mjaftueshme digjitale. Veprimet konkrete duhet të përfshijnë:

- Rishikimin e kurrikulës kombëtare aktuale për të integruar përmbajtje të lidhur me klimën në një mënyrë të strukturuar dhe ndërdisiplinore në të gjitha klasat, duke siguruar progresion të rezultateve të të nxënit – nga ndërgjegjësimi bazë mjedisor në arsimin e hershëm, deri te mendimi mbi sisteme më të ndërlikuara dhe zgjidhjet klimatike në arsimin e mesëm e të lartë.
- Zhvillimin e paketave kombëtare të edukimit mbi klimën dhe planeve mësimore, të bashkëndërtuara me hartuesit e kurrikulave, mësuesit dhe ekspertët e edukimit mjedisor. Këto burime duhet të jenë të aksesueshme falas online, të testohen në mjedise shkollore të ndryshme dhe të jenë të përshtatshme për kontekste të ndryshme lokale.
- Integrimin e përmbajtjes mbi klimën në tekstet shkollore dhe në sistemet e provimeve kombëtare, për të institucionalizuar rëndësinë e saj dhe për të siguruar mësimdhënie dhe vlerësim të qëndrueshëm në të gjitha shkollat.

“Përveç rritjes së ndërgjegjësimit mbi rreziqet dhe cenueshmëritë mjedisore, edukimi për klimën duhet të promovojë narrativa pozitive dhe vizione fuqizuese për të ardhmen.”

Trajnimi i mësuesve para dhe gjatë mësimdhënies duhet të jetë në qendër të kësaj reforme. Universitetet dhe institucionet e formimit të mësuesve duhet të përfshijnë module të detyrueshme mbi edukimin mjedisor, strategjitë pjesëmarrëse të mësimdhënies dhe mësimdhënien ndërdisiplinore në programet ekzistuese arsimore. Zhvillimi profesional duhet të jetë i vazhdueshëm dhe të mbështetet nga:

- Programet “Trajnim i Trajnerëve” (ToT), të zhvilluara në partneritet me OJF me përvojë, universitete dhe agjenci ndërkombëtare (p.sh. UNESCO, UNDP);
- Punëtori kombëtare ose rajonale mbi edukimin klimatik dhe programe certifikimi për mësuesit në detyrë dhe administratorët e shkollave.

Në nivelin e arsimit të lartë, universitetet duhet të inkurajohen që të:

- Krijojnë programe ndërdisiplinore diplome ose certifikimi në politikën klimatike, të drejtën mjedisore, planifikimin e përshtatjes ose zhvillimin e qëndrueshëm;
- Mbështesin kërkimin e aplikuar nga studentët, qendrat e inovacionit për klimën dhe nismat e gjelbra që i përfshijnë studentët në aktivitete praktike për qëndrueshmërinë;
- Vendosin partneritete me bashkitë, bizneset dhe OJF-të për të lidhur njohuritë akademike me sfidat reale klimatike.

Paralelisht me reformat në sistemin e arsimit formal, nismat e edukimit joformal duhet të zgjerohen ndjeshëm dhe të institucionalizohen si pjesë e Strategjisë Kombëtare ACE.

Këto mund të përfshijnë:

- Nisma klimatike të drejtuara nga të rinjtë, duke përfshirë akademitë rinore, klubet mjedisore dhe garat kombëtare që rrisin ndërgjegjësimin dhe nxisin veprimin;
- Programe të të nxëniet me bazë komunitare, të zbatuara nga bashkitë, OShC-të ose qendrat rinore me në focus mjedisin (p.sh., reduktimi i mbetjeve, pyllëzimi, menaxhimi i ujit);
- Mjete digjitale ndërgjegjësimi që synojnë popullësitë rurale, minoritare ose të nënpërfaqësuar.

Për të mbështetur zbatimin në shkallë të gjerë, qeveria duhet të krijojë një linjë të dedikuar buxhetore publike për edukimin mbi klimën pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Duhet të ofrohen stimuj financiarë për shkollat ose institucionet që inovojnë në mësimdhënien mbi klimën, marrin pjesë në programe pilot ose angazhojnë komunitetet e prekura. Një skemë kombëtare njohjese ose çmim (p.sh. “Shkolla e Gjelbër e Vitit”) mund të nxisë pjesëmarrje të gjerë.

Nismat e edukimit klimatik duhet të integrohen në dokumenta më të gjera të politikave kombëtare, duke përfshirë Strategjinë ACE, NDC-të e përditësuara dhe Planin Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike. Treguesit e monitorimit duhet të ndjekin numrin e edukatorëve të trajnuar, shkallën e integritit të kurrikulës, shtrirjen e programeve joformale dhe nivelin e kuptueshmërisë së studentëve mbi temat klimatike. Në këtë mënyrë, mund të sigurojmë që arsimit të mos jetë vetëm një instrument politikash, por një levë afatgjatë për transformim shoqëror dhe të sjellë qëndrueshmëri klimatike.

Ky dokument politikash përmbledh gjetjet kryesore dhe rekomandime të zbatueshme se si Shqipëria mund të hartojë dhe institucionalizojë një strategji mbi ACE, të përshtatur për kontekstin e saj kombëtar. Një strategji që fuqizon qytetarët, forcon institucionet dhe mbështet qëndrueshmërinë afatgjatë ndaj klimës.



RRETH AUTORIT



DEBORAH LIKA

është studiuese e asociuar pranë Research Institute for Sustainability (RIFS), si dhe Koordinatorë Projektësh pranë United Nations Association Albania (UNAA). Ajo ka kryer studimet në të Drejte Publike pranë Universitetit të Tiranës, dhe interesat e saj kërkimore përfshijnë politikat mjedisore, drejtësinë klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

RRETH PROJEKTIT

Projekti “Situation Analysis of ACE Implementation in Albania: Building a Policy Roadmap” financohet nga Deutsche Bundesstiftung Umwelt si pjesë e programit Small Grants for Alumni of the CEE Fellowship.

Ky projekt po zbatohet në Shqipëri pranë Shoqatës së Kombeve të Bashkuara Shqipëri (United Nations Association Albania), një OJF që punon në partneritet për të nxitur hartimin e politikave të informuara, për të inkurajuar një shoqëri pjesëmarrëse dhe të rinj të angazhuar, si dhe për të avancuar Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

BIBLIOGRAFIA

1
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. (2022, janar). Monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike, 2020–2030

2
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. (2022, shtator). Komunikimi i katërt kombëtar i Shqipërisë për ndryshimet klimatike

3
Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. (n.d.). Planifikimi Kombëtar i Përshtatjes (NAP) ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri: Korniza për procesin e vendit

4
Lika, D. (2025). Kuptimi i Kornizës së Veprimit për Fuqizimin e Klimës së UNFCCC. Dokumenti i diskutimit të RIFS, shkurt 2025

5
Republika e Shqipërisë. (2020). Ligji Nr. 155/2020 për Ndryshimet Klimatike (Ligji Nr. 155/2020 për Ndryshimet Klimatike). Botuar në Fletoren Zyrtare

6
Këshilli i Ministrave. (2023, janar). Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030

7
UNESCO dhe UNFCCC. (2016). Veprimi për fuqizim: Udhëzime për përshpejtimin e zgjidhjeve përmes edukimit, trajnimit dhe ndërgjegjësimit publik. Paris, Francë: Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO). https://unfccc.int/files/cooperation_and_support/education_and_outreach/application/pdf/action_for_climate_empowerment_guidelines.pdf

8
UNFCCC. (2021a). Programi i punës i Glasgow për Veprimin për Fuqizimin e Klimës. Vendimi -/CMA.3 i Konferencës së Palëve 26, 13 nëntor 2021. Merrni nga <https://unfccc.int/documents/310896>

9
Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. (1992). Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Data e përfundimit: 14 qershor 1992. Seria e Traktateve të Kombeve të Bashkuara në internet, numri i regjistrimit I-30822, f. 11. <https://unfccc.int/resource/docs/convkp/conveng.pdf>

BURIMET E IMAZHEVE

Kopertina: [iStock.com/ThomasFaull](https://www.iStock.com/ThomasFaull) / Fq. 6 [iStock.com/jacoblund](https://www.iStock.com/jacoblund) / Fq. 14 [iStock.com/Dynamoland](https://www.iStock.com/Dynamoland)

Research Institute for Sustainability (RIFS) at GFZ

The Research Institute for Sustainability (RIFS) kryen hulumtime shkencore me qëllim të kuptimit, promovimit dhe udhëheqjes së proceseve të ndryshimit shoqëror drejt zhvillimit të qëndrueshëm në Gjermani dhe jashtë saj. Instituti është i integruar brenda Qendrës Helmholtz për Gjeoshkencat (GFZ) dhe, si i tillë, bën pjesë në Bashkësinë Helmholtz. Qasja kërkimore e institutit është transdisiplinore, transformuese dhe bashkë-krijuese: RIFS bashkëpunon me partnerë në shkencë, institucione politike dhe administrative, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile për të kuptuar problemet e zhvillimit të qëndrueshëm, për të identifikuar zgjidhjet e duhura dhe për të mbështetur zbatimin e tyre në bashkëpunim me aktorët përkatës dhe komunitetet e prekura. Temat qendrore të kërkimit përfshijnë tranzicionin energjetik, ndryshimet klimatike dhe transformimet socio-teknologjike, si dhe qeverisjen dhe pjesëmarrjen e qëndrueshme. Një rrjet i fortë partnerësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si dhe një Program Bashkëpunëtorësh (Fellow Programme), mbështesin punën e Institutit.

Research Institute for Sustainability (RIFS) at GFZ

Berliner Straße 130
14467 Potsdam
Tel: +49 (0) 331-28822-300
media@rifs-potsdam.de
www.rifs-potsdam.de

ViSdP:

Prof. Dr. Doris Fuchs,
Scientific Director, Speaker

DOI:

10.48481/rifs.2025.031